

Fjala e hapjes së Prokurorit të Përgjithshëm znj. Arta Marku në prezantimin e Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave

E nderuar Ministre e Drejtësisë,
I nderuar zv/kryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë,
Të nderuar drejtues të prokurorive,
Të nderuar pjesëmarrës,

Takimi i sotëm është i një rëndësie të veçantë, sepse zhvillohet në zbatim të një detyrimi ligjor, të parashikuar nga neni 103 i ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Gjatë këtij takimi, nga Ministri i Drejtësisë do të bëhet prezantimi i rekomandimeve prioritare të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe që duhen ndjekur për vitin 2019, në luftën kundër kriminalitetit.

Këto rekomandime janë mjaft të rëndësishme dhe prokurorët duhet që përveç të tjerave, të orientojnë punën e përditshme në përmbushje të tyre.

Në zbatim të rekomandimeve, Prokurori i Përgjithshëm ka detyrimin të nxjerrë udhëzime të përgjithshme. Gjithashtu, Prokurori i Përgjithshëm monitoron zbatimin e këtyre udhëzimeve dhe sa ka ndikuar zbatimi i tyre mbi gjendjen e kriminalitetit në fusha të caktuara. Për të gjitha këto, informon Kuvendin, në fund të çdo viti, por edhe periodikisht nëse i kërkohet.

Zbatimi i rekomandimeve të dhëna për vitin që shkoi nga Këshilli i Ministrave është analizuar në mënyrë të detajuar në raportin vjetor të punës së institucionit të prokurorisë, depozituar para Kuvendit.

Pa humbur kohë, ftoj Ministren e Drejtësisë që të na njohë me rekomandimet e Këshillit të Ministrave, për vitin 2019.